



Tiranë më

Nr.

Prot.

**RELACION**  
**PËR**  
**PROJEKTVENDIMIN**  
**PËR**  
**PROGRAMIN E EDUKIMIT, INFORMIMIT DHE NDËRGJEGJËSIMIT TË**  
**ZGJEDHËSVE PAKICAT KOMBËTARE, PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË**  
**DATËS 11 MAJ 2025**

**I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Neni 19, pikat 1, shkronja “g” dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka parashikuar kompetencën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për të miratuar akte të cilat kujdesen për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve.

Në zbatim të kësaj dispozite, Drejtoria e Komunikimit dhe Koordinimit, ka hartuar projektvendimin “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimit të zgjedhësve pakicat kombëtare, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”, bashkëlidhur dhe programin që do të miratohet.

Duke vlerësuar nga pikëpamja e objektit që trajton ky projektvendim, vlerësohet nga ana e ligjshmërisë së është në kompetencë të Komisionerit për ta shqyrtuar.

**II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i konsideron pakicat kombëtare pjesë të pandarë të shoqërisë shqiptare. Ajo u garanton atyre barazi të plotë para ligjit në ushtrimin e lirive dhe të drejtave të tyre, duke i njohur dhe te drejtën e votës.

Programi për edukimin e zgjedhësve që i përkasin pakicave kombëtare për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025, përcakton qëllimin dhe objektivat kryesore që duhet të realizohen për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e kësaj kategorie zgjedhësish përgjatë periudhës zgjedhore. Pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë janë pakicat greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare.

*Zyrtarisht në Shqipëri njihen me ligj nëntë pakica kombëtare, konkretisht greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare.*

Hartimi i Programit për informimin e pakicave kombëtare ka për qëllim garantimin ligjor dhe zbatimin në praktikë të së drejtës për një trajtim jodiskriminues të personave që u përkasin pakicave kombëtare në gëzim të plotë të të gjitha të drejtave njerëzore, si dhe të drejtave civile e lirive politike që Kushtetuta dhe legjislacioni u njeh të gjithë shtetasve shqiptar, në këtë rast të drejtës për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur. Ky program përcakton hapat konkretë që do të ndërmerren në realizimin e objektivave tona.

Ky program është përpiluar me qëllim ofrimin e informacionit zgjedhor dhe gjithëpërfshirjen e

zgjedhësve që i përkasin pakicave kombëtare që jetojnë në vendin tonë.

Fushata e edukimit dhe informimit që përdoret për zgjedhësit do të ketë të përshtatura marrjen e informacionit zgjedhor në gjuhën e pakicave kombëtare që jetojnë në Shqipëri.

Programi për edukimin e zgjedhësve të pakicave kombëtare për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, synon ndërgjegjësimin për pjesëmarrje në votime dhe informimin e zgjedhësve mbi të gjithë procesin zgjedhor, në gjuhën që ata flasin.

Të gjitha të dhënat personale të zgjedhësve do të ruhen në zbatim të Ligjit 9887 datë 10.03.2008, kreu II, neni 5 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Ky program përmban 9 (nëntë) objektiva kryesorë, të ndara si më poshtë:

**Pjesa e parë:** Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare greke për të gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve.

**Pjesa e dytë:** Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare maqedonase për të gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve.

**Pjesa e tretë:** Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare arumune për të gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve.

**Pjesa e katërt:** Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare rome për të gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve.

**Pjesa e pestë:** Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare egjiptiane për të gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve.

**Pjesa e gjashtë:** Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare malazeze për të gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve.

**Pjesa e shtatë:** Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare boshnjake për të gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve.

**Pjesa e tetë:** Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare serbe për të gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve.

**Pjesa e nëntë:** Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare bullgare për të gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve.

## **Sfidat e Programit**

Sfidat kryesore të këtij programi janë realizimi dhe implementimi i plotë në të gjitha platformat e komunikimit i programit të edukimit. Aksesit që çdo zgjedhës të ketë në marrjen e informacionit të nevojshëm rreth procesit zgjedhor.

Për sa më lart, në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, brenda kompetencave të veta, dhe në respektim të detyrimeve e afateve ligjore të përcaktuara Kodi Zgjedhor, i propozohet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimin të zgjedhësve pakicat kombëtare, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025”.

**Monika SINANI** - Sektori i Informimit të Zgjedhësve

**Ermina ALLUSHI** - Drejtorja e Komunikimit dhe Koordinimit

**Pavlina DOÇAJ** - Drejtorja e Ligjshmërisë

**Majlinda ÇELMETA**- Sekretar i Përgjithshëm (Në mungesë dhe me urdhër)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më	
Nr.	Prot.

Data: DD MM VVVV

Nr: 000-000

Ora: HH:MM

**VENDIM**

**PËR**  
**MIRATIMIN E PROGRAMIT TË EDUKIMIT, INFORMIMIT DHE**  
**NDËRGJEGJËSIMIT TË PAKICAVE KOMBËTARE, PËR ZGJEDHJET PËR**  
**KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 11 MAJ 2025**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “g” dhe 2, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**VENDOS:**

- Miratimin e programit për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e pakicave kombëtare për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025, sipas materialit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data:

Nr:

Ora:



“Për miratimin e programit të edukimit, informimit dhe ndërgjegjësimin të pakicave kombëtare, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025”.

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE



# Edukimi, Informimi dhe Ndërgjegjësimi i Zgjedhësve të Pakicave Kombëtare

ZGJEDHJET PËR KUVEND 2025

Z G J E D H J E  
2025







# SLOGANI

## VOTO TË DËGJOHESH!

### PAKICAT KOMBËTARE



# Z G J E D H J E 2025

## PËRMBLEDHJE

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i konsideron pakicat kombëtare pjesë të pandarë të shoqërisë shqiptare. Ajo u garanton atyre barazi të plotë para ligjit në ushtrimin e lirisë dhe të drejtave të tyre, duke i njohur dhe të drejtën e votës.

Programi për edukimin e zgjedhësve që i përkasin pakicave kombëtra për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2025, përcakton qëllimin dhe objektivat kryesore që duhet të realizohen për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e kësaj kategorie zgjedhësish përgjatë periudhës zgjedhore. Zyrtarisht në Republikën e Shqipërisë njihen me ligj nëntë pakica kombëtare, konkretisht *greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare*.

Hartimi i Programit për informimin e pakicave kombëtare ka për qëllim garantimin ligjor dhe zbatimin në praktikë të së drejtës për një trajtim jodiskriminues të personave që u përkasin pakicave kombëtare në gëzim të plotë të të gjitha të drejtave njerëzore, si dhe të drejtave civile e lirisë politike që Kushtetuta dhe legjislacioni u njeh të gjithë shtetasve shqiptarë, në këtë rast të drejtës për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur.

Ky program përcakton hapat konkretë që do të ndërmerren në realizimin e objektivave tona.

Ky program është përpiluar me qëllim ofrimin e informacionit zgjedhor dhe gjithëpërfshirjen e zgjedhësve që i përkasin pakicave kombëtare që jetojnë në vendin tonë.

Fushata e edukimit dhe informimit që përdoret për zgjedhësit do të këtë të përshtatura marrjen e informacionit zgjedhor në gjuhën e pakicave kombëtare që jetojnë në Shqipëri.

Programi për edukimin e zgjedhësve të pakicave kombëtare për zgjedhjet për deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, synon ndërgjegjësimin për pjesëmarrje në votime dhe informimin e zgjedhësve mbi të gjithë procesin zgjedhor, në gjuhën që ata flasin.



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al

# QËLLIMI

Programi për edukimin e zgjedhësve të pakicave kombëtare, që jetojnë në vendin tonë për Zgjedhjet për Kuvend 2025, ka për qëllim promovimin e standarteve për zgjedhjeve të lira dhe të nderëshme, gjithëpërfshirjen e të gjithë zgjedhësve, panvarësisht gjuhëve që ata flasin, si dhe mirëinformimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për të gjitha hapat e procesit zgjedhor

Ky dokument ka për qëllim gjithashtu garantimin ligjor dhe marrjen e masave konkrete për të mbrojtur dhe respektuar të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare, si: e drejta për të shprehur lirisht përkatesinë e tyre, për të ruajtur e zhvilluar identitetin e tyre, duke ushtruar lirisht e në menyrë të papenguar ato elemente të veçanta që karakterizojnë jetën e komunitetit të tyre si pakicë, ku ndër to dhe e drejta për të votuar dhe informimi i tyre në gjuhën që ata flasin

Në mënyrë specifike programi ka si qëllim të informojë zgjedhësit e pakicave kombëtare për parandalimin e veprave penale; të informojë dhe edukojë zgjedhësit për datën e zgjedhjeve duke i orientuar ata në lidhje me procesin e verifikimit të emrit në listën e zgjedhësve dhe qendrën e votimit ku ata votojnë; ndërgjegjësimi dhe edukimi i grupeve vulnerabel dhe të rinjve votues për herë të parë, gratë, personat me aftësi të kufizuar, pakicat kombëtare që jetojnë në vendin tonë me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së tyre në zgjedhje; të informojë dhe edukojë zgjedhësit mbi procedurën e votimit dhe numërimin elektronik; të informojë dhe edukojë zgjedhësit mbi plotësimin korrekt të fletës së votimit.

## Mjetet që do të përdoren për të arritur qëllimin dhe objektivat:




Takime me  
zgjedhësit e Pakicave



Spote TV




Citylight



Media Sociale



Postera në QV



Billboard



KQZ Web

• **Periudha e zhvillimit të kësaj fushate:** 1 Janar 2025 deri ditën e zgjedhjeve.



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al



## Objektivat kryesorë të programit:

-  **1** Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare *greke* për të **gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve**.
-  **2** Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare *maqedonase* për të **gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve**.
-  **3** Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare *arumune* për të **gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve**.
-  **4** Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare *rome* për të **gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve**.
-  **5** Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare *egjiptiane* për të **gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve**.
-  **6** Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare *malazeze* për të **gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve**.
-  **7** Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare *boshnjake* për të **gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve**.
-  **8** Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare *serbe* për të **gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve**.
-  **9** Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare *bullgare* për të **gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve**.

## Audienca e synuar:

Të gjithë zgjedhësit e pakicave kombëtare të cilët jetojnë në vendin tonë, që votojnë dhe kanë mbushur moshën 18 vjeç.





1

## Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare greke për të gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve.

### • Grupi ku adresohet: Zgjedhësit që i përkasin pakicës kombëtare greke.

Ky objektivi ka për qëllim informimin e zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare greke për të gjithë hapat e procesit zgjedhor. Fokusi kryesor do të jenë; veprat penale në zgjedhje (shit-blerja e votës); informimi dhe ndërgjegjësimi kësaj pakice për denoncimin e parregullsive në zgjedhje, kur është rasti; informimi për kontrollin e emrit në listën e zgjedhësve; informimin dhe sensibilizimin i tyre mbi financimin e subjekteve zgjedhore përgjatë fushatës; informimin dhe ndërgjegjësimi i administratës publike/shtetërore për ndalimet gjatë orarit zyrtar; informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi hapat që duhet të ndjekin ata në procesin e votimit; informimin dhe edukimin e zgjedhësve mbi plotësimin korrekt të fletës së votimit; informimin dhe edukimin e zgjedhësve mbi votimin dhe numërimin elektronik.

### • Mjetet e komunikimit



**Takime me zgjedhësit** (Do të zhvillohen takime me votues për target grupet që i përkasin pakicës kombëtare greke, të cilët do të informohen mbi aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor).



**Media Sociale** (Do të postohen në këto rrjete mesazhe informuese dhe sensibilizuese me tekst në gjuhën e kësaj pakice, video, audio, për çdo objektivi të programit të informimit.)



**Web KQZ** (Në website e KQZ do të publikohet i gjithë informacioni edhe në gjuhën greke)



**Spote Televizive** (Do të transmetohen spotet për fushatën e informimit të zgjedhësve e cila do të ketë të vendosura titrat në gjuhën greke në televizionet lokale në vendet ku ata banojnë)



**Postera në qendër votimi** (Do të vendosen postera informues në qendrat e votimit për veprat penale dhe mënyrën e votimit në zonat ku zgjedhësit e pakicës greke votojnë (Finiq, Dropull)



**Billboard** (Do të vendosen postera informues në gjuhën greke në pikën e kalimit kufitar në Gjirokastër me informacione për zgjedhjet)



**Citylight** (Do të vendosen postera informues në pikat ku zgjedhësit e pakicës kombëtare greke votojnë dhe banojnë.)



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al



2

## Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare maqedonase për të gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve.

- **Grupi ku adresohet:** Zgjedhësit që i përkasin pakicës kombëtare *maqedonase*.

Ky objektivi ka për qëllim informimin e zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare maqedonase për të gjithë hapat e procesit zgjedhor. Fokusi kryesor do të jenë; veprat penale në zgjedhje (shit-blerja e votës); informimi dhe ndërgjegjësimi kësaj pakice për denoncimin e parregullsive në zgjedhje, kur është rasti; informimi për kontrollin e emrit në listën e zgjedhësve; informimin dhe sensibilizimin i tyre mbi financimin e subjekteve zgjedhore përgjatë fushatës; informimin dhe ndërgjegjësimi i administratës publike/shtetërore për ndalimet gjatë orarit zyrtar; informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi hapat që duhet të ndjekin ata në procesin e votimit; informimin dhe edukimin e zgjedhësve mbi plotësimin korrekt të fletës së votimit; informimin dhe edukimin e zgjedhësve mbi votimin dhe numërimin elektronik.

### • Mjetet e komunikimit



**Takime me zgjedhësit** (Do të zhvillohen takime me votues për target grupet që i përkasin pakicës kombëtare maqedonase, të cilët do të informohen mbi aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor).



**Media Sociale** (Do të postohen në këto rrjete mesazhe informuese dhe sensibilizuese me tekst në gjuhën e kësaj pakice, video, audio, për çdo objektivi të programit të informimit.)



**Web KQZ** (Në website e KQZ do të publikohet i gjithë informacioni edhe në gjuhën maqedonase)



**Spote Televizive** (Do të transmetohet spotet për fushatën e informimit të zgjedhësve e cila do të ketë të vendosura titrat në gjuhën maqedonase në televizionet lokale në vendet ku ata banojnë)



**Postera në qendër votimi** (Do të vendosen postera informues në qendrat e votimit për veprat penale dhe mënyrën e votimit në zonat ku zgjedhësit e pakicës maqedonase votojnë (Pustec).



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al



3

## Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare arumune për të gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve.

### • **Grupi ku adresohet:** Zgjedhësit që i përkasin pakicës kombëtare *arumune*.

Ky objektivi ka për qëllim informimin e zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare arumune për të gjithë hapat e procesit zgjedhor. Fokusi kryesor do të jenë; veprat penale në zgjedhje (shit-blerja e votës); informimi dhe ndërgjegjësimi kësaj pakice për denoncimin e parregullsive në zgjedhje, kur është rasti; informimi për kontrollin e emrit në listën e zgjedhësve; informimin dhe sensibilizimin i tyre mbi financimin e subjekteve zgjedhore përgjatë fushatës; informimin dhe ndërgjegjësimi i administratës publike/shtetërore për ndalimet gjatë orarit zyrtar; informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi hapat që duhet të ndjekin ata në procesin e votimit; informimin dhe edukimin e zgjedhësve mbi plotësimin korrekt të fletës së votimit; informimin dhe edukimin e zgjedhësve mbi votimin dhe numërimin elektronik.

### • **Mjetet e komunikimit**



**Takime me zgjedhësit** (Do të zhvillohen takime me votues për target grupet që i përkasin pakicës kombëtare arumune, të cilët do të informohen mbi aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor).



**Media Sociale** (Do të postohen në këto rrjete mesazhe informuese dhe sensibilizuese me tekst në gjuhën e kësaj pakice, video, audio, për çdo objektivi të programit të informimit.)



**Web KQZ** (Në website e KQZ do të publikohet i gjithë informacioni edhe në gjuhën arumune)



**Spote Televizive** (Do të transmetohen spotet për fushatën e informimit të zgjedhësve e cila do të ketë të vendosura titrat në gjuhën arumune në televizionet lokale në vendet ku ata banojnë)



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al



4

## Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare rome për të gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve.

- **Grupi ku adresohet:** Zgjedhësit që i përkasin pakicës kombëtare *rome*.

Ky objektivi ka për qëllim informimin e zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare rome për të gjithë hapat e procesit zgjedhor. Fokusi kryesor do të jenë; veprat penale në zgjedhje (shit-blerja e votës); informimi dhe ndërgjegjësimi kësaj pakice për denoncimin e parregullsive në zgjedhje, kur është rasti; informimi për kontrollin e emrit në listën e zgjedhësve; informimin dhe sensibilizimin i tyre mbi financimin e subjekteve zgjedhore përgjatë fushatës; informimin dhe ndërgjegjësimi i administratës publike/shtetërore për ndalimet gjatë orarit zyrtar; informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi hapat që duhet të ndjekin ata në procesin e votimit; informimin dhe edukimin e zgjedhësve mbi plotësimin korrekt të fletës së votimit; informimin dhe edukimin e zgjedhësve mbi votimin dhe numërimin elektronik.

### • Mjetet e komunikimit



**Takime me zgjedhësit** (Do të zhvillohen takime me votues për target grupet që i përkasin pakicës kombëtare rome, të cilët do të informohen mbi aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor).



**Media Sociale** (Do të postohen në këto rrjete mesazhe informuese dhe sensibilizuese me tekst në gjuhën e kësaj pakice, video, audio, për çdo objektivi të programit të informimit.)



**Web KQZ** (Në website e KQZ do të publikohet i gjithë informacioni edhe në gjuhën rome)



**Spote Televizive** (Do të transmetohen spotet për fushatën e informimit të zgjedhësve e cila do të ketë të vendosura titrat në gjuhën rome në televizionet lokale në vendet ku ata banojnë)



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al



5

## Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare egjiptiane për të gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve.

### • **Grupi ku adresohet:** Zgjedhësit që i përkasin pakicës kombëtare *egjiptiane*.

Ky objektivi ka për qëllim informimin e zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare egjiptiane për të gjithë hapat e procesit zgjedhor. Fokusi kryesor do të jenë; veprat penale në zgjedhje (shit-blerja e votës); informimi dhe ndërgjegjësimi kësaj pakice për denoncimin e parregullsive në zgjedhje, kur është rasti; informimi për kontrollin e emrit në listën e zgjedhësve; informimin dhe sensibilizimin i tyre mbi financimin e subjekteve zgjedhore përgjatë fushatës; informimin dhe ndërgjegjësimi i administratës publike/shtetërore për ndalimet gjatë orarit zyrtar; informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi hapat që duhet të ndjekin ata në procesin e votimit; informimin dhe edukimin e zgjedhësve mbi plotësimin korrekt të fletës së votimit; informimin dhe edukimin e zgjedhësve mbi votimin dhe numërimin elektronik.

### • **Mjetet e komunikimit**

Nisur nga fakti që **gjuha që ky komunitet flet është gjuha shqipe**, të gjitha mjetet e komunikimit që do të përdoren për fushatën e zgjedhjeve nga Institucioni, do të jenë të aksesueshme edhe për këtë pakicë kombëtare.



**Takime me zgjedhësit** (Do të zhvillohen takime me votues për target grupet që i përkasin **pakicës kombëtare egjiptiane**, të cilët do të informohen mbi aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor).



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al



6

## Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare malazeze për të gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve.

- **Grupi ku adresohet:** Zgjedhësit që i përkasin pakicës kombëtare *malazeze*.

Ky objektivi ka për qëllim informimin e zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare malazeze për të gjithë hapat e procesit zgjedhor. Fokusi kryesor do të jenë; veprat penale në zgjedhje (shit-blerja e votës); informimi dhe ndërgjegjësimi kësaj pakice për denoncimin e parregullsive në zgjedhje, kur është rasti; informimi për kontrollin e emrit në listën e zgjedhësve; informimin dhe sensibilizimin i tyre mbi financimin e subjekteve zgjedhore përgjatë fushatës; informimin dhe ndërgjegjësimi i administratës publike/shtetërore për ndalimet gjatë orarit zyrtar; informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi hapat që duhet të ndjekin ata në procesin e votimit; informimin dhe edukimin e zgjedhësve mbi plotësimin korrekt të fletës së votimit; informimin dhe edukimin e zgjedhësve mbi votimin dhe numërimin elektronik.

### • Mjetet e komunikimit



**Takime me zgjedhësit** (Do të zhvillohen takime me votues për target grupet që i përkasin pakicës kombëtare malazeze, të cilët do të informohen mbi aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor).



**Media Sociale** (Do të postohen në këto rrjete mesazhe informuese dhe sensibilizuese me tekst në gjuhën e kësaj pakice, video, audio, për çdo objektivi të programit të informimit.)



**Web KQZ** (Në website e KQZ do të publikohet i gjithë informacioni edhe në gjuhën malazeze)



**Spote Televizive** (Do të transmetohen spotet për fushatën e informimit të zgjedhësve e cila do të ketë të vendosura titrat në gjuhën malazeze në televizionet lokale në vendet ku ata banojnë)



**Billboard** (Do të vendosen postera informues në gjuhën malazeze në pikën e kalimit kufitar në Hanin e Hotit me informacine për zgjedhjet)



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al



7

## Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare boshnjake për të gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve.

### • **Grupi ku adresohet:** Zgjedhësit që i përkasin pakicës kombëtare *boshnjake*.

Ky objektivi ka për qëllim informimin e zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare boshnjake për të gjithë hapat e procesit zgjedhor. Fokusi kryesor do të jenë; veprat penale në zgjedhje (shit-blerja e votës); informimi dhe ndërgjegjësimi kësaj pakice për denoncimin e parregullsive në zgjedhje, kur është rasti; informimi për kontrollin e emrit në listën e zgjedhësve; informimin dhe sensibilizimin i tyre mbi financimin e subjekteve zgjedhore përgjatë fushatës; informimin dhe ndërgjegjësimi i administratës publike/shtetërore për ndalimet gjatë orarit zyrtar; informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi hapat që duhet të ndjekin ata në procesin e votimit; informimin dhe edukimin e zgjedhësve mbi plotësimin korrekt të fletës së votimit; informimin dhe edukimin e zgjedhësve mbi votimin dhe numërimin elektronik.

### • **Mjetet e komunikimit**



**Takime me zgjedhësit** (Do të zhvillohen takime me votues për target grupet që i përkasin pakicës kombëtare boshnjake, të cilët do të informohen mbi aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor).



**Media Sociale** (Do të postohen në këto rrjete mesazhe informuese dhe sensibilizuese me tekst në gjuhën e kësaj pakice, video, audio, për çdo objektivi të programit të informimit.)



**Web KQZ** (Në website e KQZ do të publikohet i gjithë informacioni edhe në gjuhën boshnjake)



**Spote Televizive** (Do të transmetohen spotet për fushatën e informimit të zgjedhësve e cila do të ketë të vendosura titrat në gjuhën boshnjake në televizionet lokale në vendet ku ata banojnë)



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al



8

## Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare serbe për të gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve.

- **Grupi ku adresohet:** Zgjedhësit që i përkasin pakicës kombëtare *serbe*.

Ky objektivi ka për qëllim informimin e zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare serbe për të gjithë hapat e procesit zgjedhor. Fokusi kryesor do të jenë; veprat penale në zgjedhje (shit-blerja e votës); informimi dhe ndërgjegjësimi kësaj pakice për denoncimin e parregullsive në zgjedhje, kur është rasti; informimi për kontrollin e emrit në listën e zgjedhësve; informimin dhe sensibilizimin i tyre mbi financimin e subjekteve zgjedhore përgjatë fushatës; informimin dhe ndërgjegjësimi i administratës publike/shtetërore për ndalimet gjatë orarit zyrtar; informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi hapat që duhet të ndjekin ata në procesin e votimit; informimin dhe edukimin e zgjedhësve mbi plotësimin korrekt të fletës së votimit; informimin dhe edukimin e zgjedhësve mbi votimin dhe numërimin elektronik.

### • Mjetet e komunikimit



**Takime me zgjedhësit** (Do të zhvillohen takime me votues për target grupet që i përkasin pakicës kombëtare serbe, të cilët do të informohen mbi aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor).



**Media Sociale** (Do të postohen në këto rrjete mesazhe informuese dhe sensibilizuese me tekst në gjuhën e kësaj pakice, video, audio, për çdo objektivi të programit të informimit.)



**Web KQZ** (Në website e KQZ do të publikohet i gjithë informacioni edhe në gjuhën serbe)



**Spote Televizive** (Do të transmetohen spotet për fushatën e informimit të zgjedhësve e cila do të ketë të vendosura titrat në gjuhën serbe në televizionet lokale në vendet ku ata banojnë)



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi




KQZShqiperi



kqz.gov.al





9

## Informimi i zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare bullgare për të gjithë hapat e procesit të zgjedhjeve.

- **Grupi ku adresohet:** Zgjedhësit që i përkasin pakicës kombëtare *bullgare*.

Ky objektivi ka për qëllim informimin e zgjedhësve që i përkasin pakicës kombëtare bullgare për të gjithë hapat e procesit zgjedhor. Fokusi kryesor do të jenë; veprat penale në zgjedhje (shit-blerja e votës); informimi dhe ndërgjegjësimi kësaj pakice për denoncimin e parregullsive në zgjedhje, kur është rasti; informimi për kontrollin e emrit në listën e zgjedhësve; informimin dhe sensibilizimin i tyre mbi financimin e subjekteve zgjedhore përgjatë fushatës; informimin dhe ndërgjegjësimi i administratës publike/shtetërore për ndalimet gjatë orarit zyrtar; informimi dhe edukimi i zgjedhësve mbi hapat që duhet të ndjekin ata në procesin e votimit; informimin dhe edukimin e zgjedhësve mbi plotësimin korrekt të fletës së votimit; informimin dhe edukimin e zgjedhësve mbi votimin dhe numërimin elektronik.

### • Mjetet e komunikimit



**Takime me zgjedhësit** (Do të zhvillohen takime me votues për target grupet që i përkasin pakicës kombëtare bullgare, të cilët do të informohen mbi aspekte të ndryshme të procesit zgjedhor).



**Media Sociale** (Do të postohen në këto rrjete mesazhe informuese dhe sensibilizuese me tekst në gjuhën e kësaj pakice, video, audio, për çdo objektivi të programit të informimit.)



**Web KQZ** (Në website e KQZ do të publikohet i gjithë informacioni edhe në gjuhën bullgare)



**Spote Televizive** (Do të transmetohen spotet për fushatën e informimit të zgjedhësve e cila do të ketë të vendosura titrat në gjuhën bullgare në televizionet lokale në vendet ku ata banojnë)



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



KQZShqiperi



kqz.gov.al

Z G J E D H J E  
2025



Edukimi, Informimi dhe  
Ndërgjegjësimi i Zgjedhësve  
të pakicave Kombëtare



2 0 2 4